



## Informacione për ankuesit

### Njoftimi i ankesës Qeverisë mbrojtëse

Në vijim të shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë së çështjes suaj Gjykata vendos, në bazë të nenit 54 § 2 (b) të Rregullores së saj, t'i kërkojë Qeverisë mbrojtëse të paraqesë me shkrim vëzhgimet e saj mbi pranueshmërinë dhe themelin e çështjes në tërësi ose mbi një apo disa nga pretendimet tuaja. Nëse Gjykata vendos me anë të një vendimi të pjesshëm të deklarojë një pjesë të pretendimeve të papranueshme, shqyrtimi i pretendimeve që janë deklaruar të papranueshme përfundon aty dhe ju nuk mund të paraqisni argumente të mëtejshme mbi këtë pjesë të çështjes.

### FAZA JOKONTRADIKTORE

#### 1. Përfaqësimi dhe ndihma ligjore

Sipas nenit 36 §§ 2 dhe 4 të Rregullores, në këtë fazë të procedurës ankuesi duhet të përfaqësohet në Gjykatë nga një avokat, përveç rasteve kur Presidenti i Dhomës vendos ndryshe. Nëse hasni vështirësi në gjetjen e avokatit, Dhoma e Avokatisë së vendit tuaj mund t'ju ndihmojë për këtë. Nëse nuk keni mundësi të mjaftueshme ekonomike për të paguar përfaqësuesin tuaj ligjor, mund të aplikoni për ndihmë ligjore nën skemën e ndihmës ligjore të Gjykatës (neni 105 e vijues i Rregullores). Megjithatë, ndihma ligjore akordohet zakonisht vetëm për çështje të ndërlikuara dhe jo për rastet që shqyrtojnë problematika që përsëriten. Pagesat e akorduara nga Gjykata si ndihmë ligjore konsistojnë në një shumë të vetme që duhet të konsiderohet si një kontribut për shpenzimet e përfaqësimit. Së fundi, fakti që ju jepet ndihma juridike nuk do të thotë që Gjykata do të caktojë një përfaqësues për ankuesin. Gjetja dhe zgjedhja e një përfaqësuesi është përgjegjësia e ankuesit.

Gjatë fazës jokontradiktore ju mund të kërkonti të vetëpërfaqësoheni. Një kërkesë e tillë do të shqyrtohet nga Presidenti (Neni 36 § 2 *in fine*).

#### 2. Zgjidhja me pajtim

##### Nëse ju është dërguar një deklaratë

Duke marrë në konsideratë jurisprudencën dhe praktikën e Gjykatës, kjo çështje mund të zgjidhet me pajtim nëse palët pranojnë kushtet e deklaratës bashkëngjitur, dhe veçanërisht, nëse Qeveria paguan ankuesin (it) në lidhje me çdo dëm, së bashku me çdo kosto dhe shpenzime të shkaktuara.

Luteni të informoni Sekretariatit e Gjykatës brenda dymbëdhjetë javësh nëse e pranoni këtë propozim. Nëse po, luteni të ktheni deklaratën bashkëngjitur, të vini datën dhe firmën tuaj sikurse ju kërkohet. Qeverisë i është dërguar një deklaratë me të njëjtat kushte, një kopje të së cilës do t'a gjeni bashkëngjitur.

##### Nëse nuk ju është dërguar asnjë deklaratë

Palëve u është kërkuar të bëjnë të ditur brenda dymbëdhjetë javësh pozicionin e tyre në lidhje me një zgjidhje me pajtim të çështjes suaj si dhe të paraqesin propozime mbi këtë mundësi (neni 62 i Rregullores). Nëse palët janë të interesuara të arrijnë një zgjidhje me pajtim, Sekretariati mund të propozojë kushtet e marrëveshjes. Nëse Qeveria paraqet një propozim të tillë, ju do të keni mundësinë të paraqisni komentet tuaja mbi këtë propozim. Negociatat për zgjidhjen me pajtim janë tërësisht konfidenciale në bazë të nenit 62 § 2 të Rregullores, dhe çdo vëzhgim apo propozim rreth tyre duhet të parashtrohet në një dokument më vete, përmbajtjes së të cilit nuk mund t'i referoheni gjatë procedurës kryesore.

#### 3. Deklarata e njëanshme

Në parim, nëse dështojnë negociatat për një zgjidhje me pajtim, Qeveria ka mundësi të dorëzojë një deklaratë të njëanshme. Kur Qeveria paraqet një deklaratë të njëanshme, Gjykata vendos, në

përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës, nëse justifikohet vazhdimi i shqyrtimit të ankesës. Nëse ankuesi pranon kushtet e deklaratës së njëanshme, Gjykata do të shqyrtojë çështjen sipas procedurës për zgjidhje me pajtim.

### **FAZA KONTRADIKTORE**

Nëse palët nuk e zgjidhin çështjen me pajtim brenda dymbëdhjetë javësh, faza kontradiktore do të fillojë dhe në këtë rast ankuesit do t'i kërkohet të përfaqësohet nga një "avokat" përpara Gjykatës, në përputhje me Nenin 36 §§ 2 dhe 4. Sikurse dhe në fazën jokontradiktore, ankuesi mund të kërkojë në mënyrë të qartë edhe në këtë fazë të procedurës të vetëpërfaqësohet. Një kërkesë e tillë do t'i paraqitet Presidentit për shqyrtim.

### **MBROJTJA E TË DHENAVE / QASJA E PUBLIKUT NË DOSJE**

Luteni të vini re se të gjitha dokumentet e çështjes janë publike<sup>1</sup>, përveç atyre që lidhen me procedurën e zgjidhjes miqësore. Për më tepër, disa dokumente, siç janë vendimet, aktgjykimet ose përmbledhja e fakteve, publikohen në faqen e Internetit të Gjykatës.

Rrjedhimisht, çdokush mund të ketë qasje tek informacionet e dosjes, e cila përfshin formularin e ankimit dhe të gjitha dokumentet e shtuara më vonë nga palët si dhe nga palët e treta, nëse ka. Nëse këto dokumente përmendin emra ose të dhëna personale, lutemi të vëreni që këto të fundit mund të publikohen, përkthehen dhe të shpërndahen. Gjithashtu, përmbajtja e dosjes mund të bëjë të mundur tërthorazi identifikimin e personave, emrat e të cilëve nuk shfaqen në dosje.

Nëse keni ndonjë kundërshtim që ky material të jetë publik dhe dëshironi të kërkonit një përjashtim, duhet të informoni Gjykatën sa më shpejt që të jetë e mundur. Ju duhet të jepni arsye të vlefshme për të justifikuar një përjashtim të tillë. Presidenti do të shqyrtojë kërkesën tuaj dhe do të vendosë nëse aksesit në dosjen e çështjes duhet të kufizohet pjesërisht ose në tërësi<sup>2</sup>.

Një palë që dëshiron t'i zbulojë një personi të tretë çdo informacion në lidhje me çështjen duhet t'i referohet politikës së mbrojtjes së të dhënave të Gjykatës ([www.echr.coe.int/privacy](http://www.echr.coe.int/privacy)), dhe detyrimeve përkatëse të së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> Neni 33 dhe 47 i Rregullores

<sup>2</sup> Neni 33 § 2 parashikon: "Qasja e publikut në një dokument ose në ndonjë pjesë të tij mund të kufizohet në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kërkohet për interesat e të miturve ose mbrojtjen e jetës private të palëve, ose në masën strikte e të domosdoshme sipas gjykimit të Presidentit në rrethana të veçanta kur publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë".

<sup>3</sup> Neni 6 i [Konventës të Këshillit të Evropës nr. 108 për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale](#) parashikon: "Të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore, opinionet politike ose besimet fetare ose besime të tjera, si dhe të dhënat personale në lidhje me shëndetin ose jetën seksuale, nuk mund të përpunohen automatikisht, përveç rasteve kur ligji i brendshëm siguron masa mbrojtëse të përshtatshme. E njëjta gjë vlen dhe për të dhënat personale në lidhje me dënimet penale".